

VENDIM
Nr.649, datë 17.10.2005

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2005, MIRATUAR PËR MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE PËR SHPËRBLIMIN E SPORTISTËVE, QË MORËN PJESE NË KAMPIONATIN EUROPIAN TË PESHËNGRITJES PËR TË RINJ, NË SLLOVAKI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e vitit 2005, në zërin “Grant për sportin cilësor”, t’i shtohet fondi prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh, për shpërblimin e sportistëve të peshëngritjes, për rezultatet e larta të arritura në kampionatin europian të peshëngritjes për të rinj, të zhvilluar në Sllovaki, në datat 1-8 tetor 2005.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të përcaktojë masën e shpërblimit për sportistët, që kanë fituar medalje dhe për trajnerët e tyre.
 4. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha